


Republika e Kosovës / Republika Kosove
Komuna e Gjakovës / Opština Djakovica



01 Nr. B. 112 dt. 6196
03-02-2016

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS / OPŠTINA DJAKOVICA
MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Në bazë të kompetencave të përcaktuara me dispozitën e nenit 51 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 41 të Statutit të Komunës së Gjakovës dhe lidhur me detyrimin ligjor për zbatimin e Vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Kosovës (KPMShCK) i përcaktuar me nenin 13 të Ligjit nr. 03/L-192, Kryetarja e Komunës së Gjakovës me datën 03.02.2016 mori këtë

AKTVENDIM

1. Zbatohet Vendimi i KPMShCK nr. A/02/532/2015 të datës 15.12.2015 ashtu që punëtorja Znj. Teuta Vokshi kthehet në vendin e saj të mëparshëm të punës Udhëheqëse e Sektorit të Statusit Civil.
2. Punëtorja është e obliguar ta fillon punën në vendin e saj të mëparshëm të cekur në pikën paraprake me datën 08.02.2016.
3. Ky Aktvendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetimi

Me Vendimin e KPMShCK nr. A/02/532/2015 të datës 15.12.2015, është anuluar Vendimi I Komisionit disiplinor të Komunës së Gjakovës nr. 01.116-24152 dhe 01-116-40125/2015 të datës 31.07.2015 me të cilin, punëtore Teuta Vokshi iu ishte shqiptuar masa disiplinore "Largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi gradimi deri në pesë (5) vjet", dhe është obliguar Komuna e Gjakovës që punëtoren në fjalë ta kthen në vendin e saj të mëparshëm të punës "Udhëheqëse e Sektorit të Statusit Civil" në Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative, në Komunën e Gjakovës.

Meqenëse Vendimi i KPMShCK është i plotfuqishëm në procedurën administrative dhe nisur nga detyrimi ligjor për zbatueshmërinë e tij, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Kryetarja e Komunës së Gjakovës

Mimoza Kusari-Lila

I dorëzohet:

Punëtore : Teuta Vokshi

Arkivit Komunal

